


# FLETA E FAKTEVE: DHUNA NË FAMILJE

Dhunë në familje është çdo sjellje që është abuzive nga ana fizike, seksuale, emocionale ose psikologjike ose që në ndonjë mënyrë tjetër e kontrollon ose dominon anëtarin e familjes apo e intimidon atë. Dhuna përdoret për të fituar pushtet dhe kontroll mbi një anëtar të familjes.

Dhuna nuk është vetëm fizike. Dhuna në familje mund të jetë edhe seksuale, emocionale, psikologjike, sociale, verbale dhe shpirtërore.



**Burimi:** National Council to Reduce Violence against Women and their Children. (2009). Background paper to Time for Action: The National Council's Plan for Australia to Reduce Violence against Women and their Children, 2009-2021. National Council to Reduce Violence against Women and their Children. Canberra.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.

# FLETA E FAKTEVE: DHUNA KUNDËR GRAVE

Dhuna kundër grave është çdo lloj dhune që u shkakton grave dëmtim ose vuajtje.




Shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra dhe shumica e autorëve janë burra.




'MË SHUMË SE 9 NGA 10

autorë të dhunës në familje kundër grave janë meshkuj.



Gratë, ka më shumë të ngjarë që ta vuajnë këtë dhunë nga një

**PARTNER OSE ISH-PARTNER MASHKULL**



28 përqind e grave kanë pësuar dhunë nga një partner ose ish-partner mashkull, i dashuri ose nga persona që frekuentojnë

## Burimi

Australian Bureau of Statistics. (2012). Personal Safety Survey. Canberra: Australian Bureau of Statistics.

Diemer, K. (2012). *Measuring family violence in Victoria: Victorian family violence database (Volume 5)*. Melbourne, Victoria: Department of Justice.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.

# FLETA E FAKTEVE: MITE TË ZAKONSHME RRETH DHUNËS KUNDËR GRAVE

MITI  
1

**BURRAT DUHET TË MARRIN VENDIME DHE TË MARRIN NËN KONTROLL MARRËDHËNIET.**

**FAKT: Dhuna është më e zakonshme në familjet dhe në lidhjet ku burrat kontrollojnë vendimmarrjen, dhe më pak në ato lidhje ku gratë kanë një shkallë më të madhe pavarësie.**

Bindja se burrat dhe gratë kanë role ose karakteristika të ndryshme (qoftë në marrëdhëniet e tyre apo në shoqëri në përgjithësi) njihet si stereotip. Studimet ndërkombëtare kanë treguar vazhdimisht se besimi në këta stereotipa është një prej parashikuesve kryesorë të dhunës. Pra, individët që kanë këto bindje kanë më shumë të ngjarë të kryejnë dhunë kundër grave dhe vendet ku stereotipi gjinor është më i pranueshëm kanë nivele më të larta dhune kundër grave.

Ne e dimë se dhuna është më pak e zakonshme në shoqëritë ku burrat dhe gratë janë më të barabartë në marrëdhëniet e tyre dhe ku nuk pritet që ata të luajnë role të ndryshme bazuar në gjininë e tyre. Barazia më e madhe dhe rolet gjinore më fleksibël u japin të gjithëve më shumë mundësi për të zhvilluar kapacitetin e tyre të plotë.

MITI  
2

**DHUNA NË FAMILJE ËSHTË E PRANUESHME NËSE DIKUSH ZEMËROHET AQ SHUMË SA HUMB KONTROLLIN.**

**FAKT: Dhuna kundër grave është diçka më shumë sesa thjesht humbje e gjakftohtësisë.**

Nuk ka justifikime për sjellje të dhunshme. Asnjëherë. Dhuna shkaktohet nga qëndrimi i një individi kundër grave dhe qëndrimet sociale që thonë se dhuna e burrave kundër grave është e pranueshme.

MITI  
3

**NËSE DUAN, GRATË MUND TË LARGOHEN NGA NJË LIDHJE E DHUNSHME.**

**FAKT: Gratë janë në rrezik dhune ekstreme, duke përfshirë edhe vrasjen, kur përpiqen të largohen ose pasi janë larguar nga një lidhje e dhunshme. Për gratë është jashtëzakonisht e vështirë të largohen nga një lidhje e dhunshme për shkak të frikës për sigurinë e tyre dhe për sigurinë e fëmijëve.**

Nuk duhet të fajësojmë gratë për dhunën nëse ato nuk largohen.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.

# FLETA E FAKTEVE: MITE TË ZAKONSHME RRETH DHUNËS KUNDËR GRAVE



## GRATË KANË MË SHUMË MUNDËSI TË PËRDHUNOHEN NGA NJË I PANJOHUR NË NJË VEND PUBLIK.

**FAKT: Si burrat ashtu edhe gratë kanë më shumë të ngjarë të ngacmohen seksualisht nga dikush që e njohin sesa nga një i panjohur.**

Sipas Zyrës Australiane të Statistikave, 15 përqind e grave dhe 3 përqind e burrave të moshës 18 vjeç e lart janë ngacmuar seksualisht nga një person i njohur. Kjo krahasuar me 3,8 përqind e grave dhe 1,6 përqind e burrave që janë ngacmuar seksualisht nga një i panjohur.

Miti i rrezikut të të ngacmuarit seksualisht nga të panjohurit, është një prej arsyeve pse gratë ngurrojnë të raportojnë një sulm seksual të kryer nga një person i njohur. Ato mund të kenë frikë se askush nuk do t'i besojë, ose se ato e kanë inkurajuar autorin e sulmit në një farë mënyre. Pas rënies së këtij miti, gratë do të jenë më të gatshme të dalin përpara dhe të raportojnë sulmet nga një person i njohur.



## SHUMË GRA BËJNË DEKLARIME TË RREME RRETH DHUNËS NË SHTËPI APO SULMEVE SEKSUALE.

**FAKT: Deklarimet e rreme të dhunës në shtëpi apo sulmeve seksuale janë jashtëzakonisht të rralla.**

80 përqind e grave që pësojnë dhunë nga partneri aktual nuk kontaktojnë me policinë për dhunën.

E njëjta gjë është e vërtetë me ngacmimet seksuale: 80 përqind e grave nuk i raportojnë ngacmimet seksuale në polici.

Mund të jetë shumë e vështirë për gratë që t'i tregojnë dikujt për dhunën, prandaj është e rëndësishme që t'u besojmë atyre.

### Burimi:

Our Watch. (2015). Myths about violence. Retrieved from [www.ourwatch.org.au/Understanding-Violence/Myths-about-violence](http://www.ourwatch.org.au/Understanding-Violence/Myths-about-violence)


Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.



# FLETA E FAKTEVE: DHUNA KUNDËR FËMIJËVE



Fëmijët shpesh janë të pranishëm kur ka dhunë në shtëpi.



Mbi 50 përqind e grave australiane që pësojnë dhunë në familje gjatë jetës së tyre kujdesen për fëmijët e tyre gjatë kësaj kohe.



Një në katër të rinj (mosha 12 deri 20 vjeç) kanë qenë dëshmitarë të dhunës kundër nënës ose njerësisë së tyre.

Kur fëmijët pësojnë dhunë dhe abuzim ky njihet si

**ABUZIM ME FËMIJËT**

## KUR NËNAT PËSOJNË DHUNË,

fëmijët e tyre ka të ngjarë të vuajnë edhe ata nga abuzimi. Kjo ndodh sepse i njëjti person është i dhunshëm ndaj nënës dhe fëmijës ose fëmija mund të lëndohet kur është i pranishëm në aktet e dhunës. Fëmijët gjithashtu mund të neglizhohen nga prindërit e tyre.

### Burimet:


Australian Bureau of Statistics. (2006). *Personal Safety Survey*. Canberra: Australian Bureau of Statistics.

Laing, L. (2003). Domestic violence in the context of child abuse and neglect. Issues paper, Australian Domestic and Family Violence Clearinghouse, UNSW, Sydney.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.




# FLETA E FAKTEVE: DHUNA KUNDËR BURRAVE



Dhuna kundër burrave ka më shumë të ngjarë të kryhet nga burra të tjerë, zakonisht një mashkull i panjohur ose një mik mashkull apo i njohur i rastësishëm.



Vetëm 5 përqind e dhunës kundër burrave kryhet nga një partnere ose ish-partnere femër dhe 3,5 përqind nga një e dashur. (ose femër që frekuenton).



Kur burrat janë viktime të dhunës në familje kjo kryhet zakonisht nga

## TË AFËRMIT MESHKUJ

të tillë si baballarët, vëllezërit ose të afërmit e tjerë.

### Burimi:

Australian Bureau of Statistics. (2012). *Personal Safety Survey*. Canberra: Australian Bureau of Statistics.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.



# FLETA E FAKTEVE: NDIKIMET E DHUNËS NË FAMILJE NË KOMUNITETIN TONË

Dhuna në familje ka ndikime të rënda në shëndetin dhe mirëqenien e një personi.



Në Viktoria, dhuna e partnerëve intimë ndaj grave është shkaku më i madh për sëmundjet dhe vdekjet e parakohshme të parandalueshme, te gratë e moshës 15 deri 44 vjeç, sesa çdo faktor tjetër rreziku duke përfshirë tensionin e lartë, obezitetin dhe duhanin.



Dhuna kundër fëmijëve mund të shkaktojë lëndime dhe gjymtime.

Kostoja totale e dhunës në shtëpi në ekonominë australiane llogaritet në

## \$13.6 MILIARDË DOLLARË



Gratë që kanë pësuar dhunë ka më shumë të ngjarë të kenë ankth dhe depresion dhe/ose çrregullime të të ngrënit. Ato ka më shumë të ngjarë të kenë probleme me alkoolin, me duhanin dhe përdorimin e drogave.

Fëmijët që kanë vuajtur ose kanë parë dhunë në familje, mund të vuajnë nga depresioni, ankthi, traumat, agresioni, sjellja anti-sociale, vetëbesimi i ulur, frika, problemet emocionale dhe konflikte me bashkëmoshatarët.

### Burimet:

Braaf, R. (2012). *Health impacts on domestic and family violence*. Sydney, Australian Domestic and Family Violence Clearinghouse, UNSW.

National Council to Reduce Violence Against Women and their Children. (2009). *Economic Costs of Violence against Women and their Children*. Commonwealth Government of Australia, Department of Families, Housing, Community Services and Indigenous Affairs, Canberra,

Richards, K. (2011). Children's exposure to domestic violence in Australia. *Trends and issues in crime and criminal justice*, No. 419, June 2011.

Vichealth. (e panjohur). *How violence against women affects health*. Marrë nga [www.vichealth.vic.gov.au/Programs-and-Projects/Freedom-from-violence/PVAW-overview.aspx](http://www.vichealth.vic.gov.au/Programs-and-Projects/Freedom-from-violence/PVAW-overview.aspx)

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.



MonashHealth



# FLETA E FAKTEVE: MBËSHTETJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Shpesh, njerëzit u drejtohen drejtuesve dhe komuniteteve të tyre fetare për ndihmë dhe mbështetje në momente të vështira. Ata që kanë pësuar dhunë në familje mund të kërkojnë mbështetje dhe këshilla nga komunitetet e tyre fetare. Mund të jetë e vështirë që të kuptoni se çfarë duhet të thoni ose të bëni, por është e rëndësishme të keni parasysh që të jeni të ndjeshëm dhe të jepni ndihmë dhe mbështetje. Kini parasysh që:

T'I BESONI PERSONIT DHE T'I LINI TË KUPTOJË SE E BESONI.

TË DËGJONI SE ÇFARË KA KALUAR.

TË MOS JENI PARAGJYKUES.

T'I THONI SE NUK E KA AI FAJIN PËR DHUNËN.

TA MBANI TË FSHEHTË HISTORINË E PERSONIT, SEPSE DUKE U TREGUAR TË TJERËVE MUND TA VENDOSNI ATË NË RREZIK PËR MË SHUMË DHUNË.

TË RESPEKTONI VENDIMET E PERSONIT.

TË OFRONI INFORMACIONIN E DUHUR RRETH SHËRBIMEVE TË NDIHMËS SIÇ JANË 1800 RESPECT (1800 737 732) OSE "SAFE STEPS FAMILY VIOLENCE" (1800 015 188).

Mbështetja e dikujt që ka përjetuar dhunë në familje mund të jetë e dhimbshme. Është e rëndësishme që të kujdeseni për veten tuaj dhe të keni parasysh se:

**Ndihma dhe mbështetja juaj është e rëndësishme.**

**Mos e vendosni veten nën presion për të dhënë më shumë mbështetje sesa mund të jepni.**

**Flisni me një shërbim nëse nuk jeni i sigurt ose ndiheni i tronditur.**

Përshtatur nga: Domestic Violence Resource Centre Victoria (<http://www.dvrcv.org.au/help-advice/guide-for-families-friends-and-neighbours>)

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.





# FLETA E FAKTEVE: ÇFARË THOTË LIGJI RRETH DHUNËS NË FAMILJE?

Të gjithë kanë të drejtën të jetojnë një jetë të sigurt pa dhunë dhe abuzim. Është kundër ligjit që dikush të dëmtojë fizikisht, të kërcënojë apo të shtrëngojë ose detyrojë një tjetër që të kryejë kontakt seksual.

Nëse dikush është në rrezik aktual, ose nëse është sulmuar fizikisht ose seksualisht, kërcënuar apo ndjekur nga mrapa, personi mund të telefonojë policinë në numrin 000.

Në Viktoria, nëse dikush ka nevojë për mbrojtje nga dhuna e mëtejshme, ky person mund të aplikojë për një Urdhër Ndërhyrjeje. Edhe policia mund të aplikojë për një Urdhër Ndërhyrjeje për llogari të një personi. Urdhri i Ndërhyrjes është një vendim gjyqate që mund të thotë se abuzuesi duhet të zbatohet kushte të ndryshme si p.sh. nuk mund ta dëmtojë apo kërcënojë personin, ose nuk mund t'i afrohet apo ta kontaktojë personin. Nëse abuzuesi nuk e zbaton Urdhrin e Ndërhyrjes, ai mund të akuzohet për shkelje penale.

## RAPORTIMI I DHUNËS NË FAMILJE

Në Viktoria, personat që janë në pozicione të caktuara duhet të raportojnë nëse një fëmijë ka vuajtur apo është në rrezik dëmtimi fizik apo abuzimi seksual. Në këta persona përfshihen mjekët, infermieret, mamitë, mësuesit, drejtorët e shkollave, psikologët e regjistruar ose kushdo tjetër që ka kualifikime universitare për punën me të rinjtë, ose në shërbime sociale dhe që punon në shëndetësi, arsim, komunitet ose shërbime sociale.

Nëse një drejtues fetar mban një (ose më shumë) nga këto pozicione, atëherë ai është i detyruar që të raportojë rrezikun e dëmtimit fizik ose seksual ndaj një fëmije.

Në Viktoria, drejtuesit fetarë nuk janë të detyruar ligjërisht të raportojnë dhunën në familje kundër të rriturve.



### Burimet:

Domestic Violence Resource Centre Victoria. (<http://www.dvrcv.org.au/help-advice/are-you-happy>)

Australian Institute of Family Studies.

(<https://www3.aifs.gov.au/cfca/publications/mandatory-reporting-child-abuse-and-neglect>)

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.



# FLETA E FAKTEVE: SI TA NDALJMË PËRHAPJEN E DHUNËS KUNDËR GRAVE?

Ne mund të marrim masa që ta ndalojmë dhunën kundër grave përpara se ajo të ndodhë. Kjo gjë njihet si parandalim paraprak.

Fillimisht duhet të kuptojmë se pse ndodh dhuna kundër grave.

## PUSHTETI I PABARABARTË MES BURRAVE DHE GRAVE

Pushteti dhe influenca që kanë burrat dhe gratë nuk është i barabartë. Shpesh, burrat kanë pushtet më të madh në jetën publike dhe private. Për shembull, burrat shpesh kanë pozicione drejtuese në politikë, biznes dhe fé. Ata mund të kenë gjithashtu edhe pushtet më të madh në marrëdhëniet e tyre dhe në shtëpi.

## ROLET STRIKTE GJINORE DHE STEREOTIPAT

Rolet gjinore dhe stereotipat janë bindjet rreth asaj se çfarë do të thotë të jesh "burrë" dhe "grua". Kjo përfshin atë se çfarë do të thotë sjellje e duhur për burrat dhe për gratë në lidhje me, për shembull, punën, rolet në shtëpi, rritjen e fëmijëve, argëtimin dhe veshjen.

Pra, cilët janë faktorët kryesorë që shkaktojnë dhunën kundër grave?

- Pushteti i pabarabartë mes burrave dhe grave.
- Rolet strikte gjinore dhe stereotipat.
- Qëndrimet sociale që justifikojnë dhunën nga burrat.

## QËNDRIMET SOCIALE QË JUSTIFIKOJNË DHUNËN NGA BURRAT

Këto norma sociale janë bindje në shoqërinë tonë, ku ndihet se është e pranueshme që burrat të jenë të dhunshëm. Këto lloje normash sociale mund të shihen në mbarë shoqërinë tonë si p.sh. në sport, në media dhe se si përshkruhen burrat si "të fortë".

Këta faktorë kyçë mbështesin bindjet dhe veprimet, që bëjnë që gratë të trajtohen me më pak respekt dhe dinjitet në marrëdhëniet e tyre.

Faktorë të tjerë të tillë si varfëria, alkooli, dëshmimtar i dhunës në moshë të vogël, ose pasja e miqve të dhunshëm janë faktorë në dhunën kundër grave. Këta faktorë mund të kontribuojnë në dhunën kundër grave, por nuk e shkaktojnë atë.

## PËR TË PARANDALUAR DHUNËN KUNDËR GRAVE, NE DUHET T'I JAPIM PËRGGJIGJE PABARAZISË GJINORE.

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.

# FLETA E FAKTEVE: RËNDËSIA E BARAZISË GJINORE NË PARANDALIMIN E DHUNËS KUNDËR GRAVE

Studimet tregojnë se vendet me barazi më të madhe gjinore mes grave dhe burrave kanë nivelet më të ulëta të dhunës kundër grave.

Ne mund t'i japim përgjigje pabarazisë gjinore si individë, në komunitetet tona dhe në shoqërinë tonë më të gjerë.

	SHEMBUJ
<b>Si individë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të flasim kundër stereotipave gjinorë.</li><li>• Të sfidojmë qëndrimet që mbështesin dhunën e burrave kundër grave.</li><li>• Të promovojmë respektin në marrëdhëniet.</li></ul>
<b>Si komunitet</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të përfshijmë gratë në pozicione vendimmarrëse.</li><li>• Të përfshijmë gratë në pozicione drejtuese.</li></ul>
<b>Si shoqëri</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të jemi në favor të ndryshimeve në strukturat dhe praktikatat që janë të pabarabarta për gratë.</li></ul>

## Burimet:

United Nations Development Fund for Women. (e panjohur).

*Investing in gender equality: Ending violence against women and girls.* Marrë nga

[www.endvawnow.org/uploads/browser/files/genderequality\\_vaw\\_leaflet\\_en\\_web.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/genderequality_vaw_leaflet_en_web.pdf)

Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.

